



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.15/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi në konfliktin administrativ të paditësit “Kompania Rajonale e Ujësjiellit” Sh.A. me seli në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.S, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 598,325.51 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur me datë 20.09.2022 në prani të përfaqësuesve të paditësit, M.S dhe B.A, dhe në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të të paditurit, mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Kompania Rajonale e Ujësjiellit” Sh.A. me seli në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.S.
- II. ANULOHET PJESËRISHT vendimi nr. 425/2019 i datës 03.12.2019, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë dhe atë periudha tatimore për vitin 2012 dhe 2013, referuar mospranimit të humbjeve të ujit dhe mos pranimit të zhvlerësimit të aseteve të rrjetit–Gypave, sipas Raportit të kompanisë së licencuar G..., kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE, tek e paditura.
- III. Vlerësimet tjera mbasin në fuqi sipas raportit të kontrollit të datës 03.09.2019, dhe sipas njoftim vlerësimeve nga e paditura, si dhe ndryshimet sipas pikës II, të dispozitivit të Vendimit nr. 425/2019 i datës 03.12.2019,
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 26.12.2019, dhe precizimin e padisë së datës 29.01.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurit

Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë, ndaj vendimit nr. 425/2019 i datës 03.12.2019, për shkak se vendimi kontestues është i përfshirë në shkelje absolute të dispozitave të procedurës, në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me kërkesë që të aprovohet padia e paditësit si e bazuar dhe të anulohet vendimi i ATK-së nr. 425/2019 i datës 03.12.2019, dhe ti kthehet të paditurës lënda në rivendosje. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i paditësit deklaroi se: Padinë e kemi bazuar duke u thirrur në 2 (dy) pika, Ligji Nr.05/L-037, neni 22 ku jep definicionin se kur lind detyrimi tatimor. Detyrimi lind në momentin kur lëshohet një faturë tatimore, ndërsa në rastin tonë tatimor nuk është lëshuar asnjë faturë për shkak të vjetërsisë së rrjetit-gypave, për arsye se rrjeti i ka mbi 80 vite vjetërsi dhe ka humbje të mëdha, dhe ë këtë rast na janë tatuar humbjet e ujit sikurse të ishin furnizime. Ndërsa pika e dytë, Vendimi Shpjegues nr.05/2009 nënshkruar nga ATK, neni 4 pika 2.2 thotë në rast se Kompania ka aktivizuar një kompani të licencuar për Rivlerësim të Pasurisë-Aseteve, atëherë ATK-ja është e detyruar me pranuar zhvlerësimin, në rastin konkret paditësi e ka angazhuar kompaninë e licencuar për të bërë rivlerësimin e pasurisë, ndërsa ATK-ja nuk e pranon pjesërisht këtë zhvlerësim, respektivisht nuk i pranon vetëm rrjetin e ujit, rrjet ky i cili përbëhet nga gypat, me të vetmin arsyetim sepse është dashur që të emërtohen gypa dhe jo rrjet. Për njoftim të gjykatës vetë ATK me rastin e ushtrimit të Kontrollit përmes Inspektorit Tatimor F.M, për periudhën tatimore 2007-2011 në raport me këtu paditësin e pranon komplet zhvlerësimin përfshirë edhe rrjetin-gypat. Ndërsa zyrtari tjetër i ATK-së, J.B pasi kryen Kontrollin për vitin 2012-2013 nuk e pranon komplet zhvlerësimin, dhe atë zhvlerësimi që i referohet rrjetit-gypave, ndërsa arsyet e ndryshimit nuk i ka cekur, dhe këtu kemi një kundërshtim ndërmjet Raporteve të vetë ATK-së dhe aplikim të Standardeve të Dyfishta në raport me çështjen kontestuese Zhvlerësim i Aseteve. E njoftojmë gjykatën se dispozitivi i vendimit kontestues është kontradiktor me arsyetimin, ngase i njëjti edhe pse e ka aprovuar pjesërisht ankesën numër nuk ka asnjë pikë në këtë dispozitiv që përcakton se çfarë ka mbetur në fuqi, andaj, si i tillë është i kundërligjshëm dhe duhet të anulohet në këtë pikë, përderisa për pjesën e aprovuar vendimit të mbetet në fuqi. Për fund, kërkoj që të aprovohet padia si e bazuar, të anulohet pjesërisht vendimi kontestues dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje pranë ATK-së, dhe atë për periudhën kontestuese 2012-2013, referuar Mospranimin të Humbjeve të Ujit dhe mos pranimin e Zhvlerësimin të Aseteve Rrjetit – Gypave, sipas Reportit të Kompanisë së licencuar G... . Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 13.07.2021, ka kundërshtuar pretendimet e paditësit të parashtruara në padi si të pabazuara në ligj dhe fakte materiale dhe vlerëson se vendimi i DA-së nr. ... i datës 03.12.2019, ka mbështetje ligjore dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i të paditurit edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar, dhe nuk e ka arsyetuar mungesën, andaj gjykata ka proceduar tutje komfor nenit 41, të LKA-së. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 20.09.2022 ka administruar provat dhe atë: Vendimi 425/2019 i datës 03.12.2019, Raporti i Kontrollit i datës 03.09.2019, Marrëveshjet e Monitorimit dhe Kontrollit të datës 09.02.2012, 05.02.2013, Parashtrësat e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik nr.192/02.02.2012, 245/12.02.2013, E-mail-at e datës 08.02.2013, 07.02.2013, 31.01.2013, 24.01.2013, Vendimi Shpjegues Publik nr.05/2009, Pasqyra e Pozitës Financiare e këtu paditësit e datës 31.12.2013, Pasqyra Financiare dhe Raporti i Auditorëve e këtu paditësit e datës 31.12.2013, Certifikata e Regjistrimit në ARBK e datës 31.05.2007, së bashku me Informatat mbi Biznesin, Urdhëresa nr.001 e datës 01.01.2003, Raporti Periodik për periudhën 02.01.2003 deri 31.12.2003, Njoftim Vlerësimi për Borxhet nr. ... i datës 30.09.202, Përgjigja në padi e datës 13.07.2020, Listë Distribuimi e ATK-së e datës 11.11.2019, Ankesa e ushtruar në ATK 425/2019 e datës 11.09.2019, Tabela Gjendja e Borxheve e ATK-së e datës së printimit 24.06.2021.

Gjykata, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e

shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi ka pranuar raportin e kontrollit të datës 03.09.2019, nga e paditura, me q ‘rast nga gjetjet e të njëjtit janë aplikuar ndryshime në llojet e tatimit TVSH-ë, CD dhe WR për periudhën 2012 - 2013. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë departamentit të ankesave në ATK-ë, e për të cilën ankesë, ATK-ja me datë 03.12.2019, ka sjell vendimin nr. 425/2019, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka Aprovuar pjesërisht ankesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, ka ndryshuar njoftim rivlerësimit e tatimit shtesë për tatimin mbi të ardhurat e korporatave CD periudha 2012 dhe 2013, e ndaj të cilit akt paditësi me padinë e datës 26.12.2019, ka iniciuar këtë konflikt administrativ.

Gjykata nga vendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se fillimisht dispozitivi i vendimit të kontestuar nuk përmban asnjë pikë se çka ka mbetur në fuqi nga ndryshimi i aplikuar në periudhën tatimore 2012 dhe 2013, sipas aprovimit të pjesshëm nga e paditura, pastaj arsyetimi i vendimit kontestues nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes administrative në shqyrtim, dhe një arsyetim i tillë për Gjykatën është i mangët dhe i pa qartë dhe kontradiktor. Gjykata vlerëson se vendimi i atakuar përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij, dhe si i tillë edhe nuk mund të ekzaminohet, e sidomos nëse nuk është konstatuar drejtë gjendja faktike, si dhe kur provat nuk janë të arsyetuara veç e veç dhe të ndërlidhura së bashku, andaj doemos edhe është dashur të anulohet pjesërisht.

Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, Gjykata pasi ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative dhe provave të theksuara në arsyetimet e vendimeve të të paditurës, nuk mund të vërtetohet plotësisht gjendja faktike dhe se ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura pa i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. E paditura në arsyetim të vendimit kontestues ka përshkruar vetëm bazën ligjore dhe atë nenin 19, nga ligji 03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe vendimit shpjegues publik nr. 05/2009.

E paditura një konstatim të tillë do të duhej ta bazonte në prova dhe dëshmi konkrete dhe jo vetëm ti mjaftonte ky konstatim abstrakt dhe se arsyetimi i tillë i pa-qartë dhe kontradiktor është i barasvlershëm me mungesë të arsyetimit e që paraqet shkelje në dëm të këtu paditësit e pa evitimin e të cilës nuk mund të procedohet tutje.

Gjykata nga administrimi provave në këtë lëndë të konfliktit administrativ, ka gjetur se e paditura në raportin e kontrollit të datës 03.09.2019, e i cili është vërtetuar me vendimin kontestues nga departamenti i ankesave pranë ATK-së, nuk ka pranuar si shpenzime zhvlerësimin e asetëve sipas rivlerësimit të bërë nga kompania G..., ngase sipas të paditurës tatimpaguesi këtu paditësi nuk i plotëson kushtet sipas nenit 4, paragrafi 2, pika 2.2 të vendimit Shpjegues Publik nr. 05/2009, por pa bërë një ndarje në vendimin kontestues se cilat asete nuk janë pranuar si shpenzim i zhvlerësimit sipas rivlerësimit të bërë nga kompania kontraktuese si më lartë për këtu paditësin derisa vet e paditura ne arsyetim të vendimit kontestues konstaton se tatimpaguesit i takojnë shpenzimet e zhvlerësimit sipas sqarimeve të këtu paditësit të datës 01.01.2003, prezantuar në procedurë administrative pranë të paditurës. Pastaj e paditura nuk e ka sqaruar secilin pozicion të pranimit ose të mos pranimit të atyre shpenzimeve të zhvlerësimit në raport me bazën ligjore në fuqi për ta konsideruar si konstatim të drejtë gjendjen faktike. Për Gjykatën këto si më lartë japin të dhëna se nuk mund të shqyrtohet ky konflikt administrative në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative nga e paditura, për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht e për ato të vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, andaj edhe doemos duhen anuluar pjesërisht dhe atë në pikat kontestuese akti administrativ dhe lënda të kthehet në rishqyrtim – rivendosje pranë të paditurës për eliminimin e të metave si më lartë. Për më tepër e paditura lidhur me zhvlerësimin e asetëve ka edhe një vendim shpjegues publik nr. 05/2009 të datës 12.11.2009, dhe e cila në nenin 4, flet për metodologjinë e njohjes së lejuar të asetëve, ndërsa në paragrafin 2.2 të këtij neni shprehimisht përcakton si të pranueshëm vlerësimin e bërë nga vlerësues të pavarur e të kualifikuar sikurse që ka vepruar këtu paditësi përmes rivlerësimit të bërë nga kompania G..., por e cila nuk është pranuar nga e paditura.

Tutje lidhur me konstatimin e dhënë në arsyetimin e vendimit kontestues nga e paditura që lidhet me qarkullimin tatimor shtesë nga humbjet e ujit duke u referuar në publikimet

nga ZRRUK-ë, informatat nga ARRU-ja dhe informatat nga kompania por pa sqaruar se për cilat publikime dhe informata po bëhet fjalë, çfarë provojnë këto publikime dhe këto informata, nga cila kompani e referuar janë marrë ashtu siç është theksuar, tuje nuk është sqaruar se a janë administruar si provë nga e paditura në procedurë administrative këto të dhëna dhe çfarë fuqie provuese kanë pasur të njëjtat për këtu të paditurën në procedurë ankimore. Pastaj sipas publikimeve dhe informatave e të cilat vetëm janë përshkruar në arsyetim të vendimit kontestues pa referenca në numra dhe data përkatëse, nga e paditura janë konstatuar mungesat e sasive të ujit të prodhuara e të cilat nuk janë faturuar nga këtu paditësi, mbi bazën e të cilave ka dalë edhe qarkullimi shtesë referuar nenit 19, të ligjit 03/L-222, po pa theksuar qartë se cilat elemente nga dispozita e nenit si më lartë nuk janë plotësuar në rastin konkret për Gjykatën paraqet fakte shtese se lënda duhet trajtuar prapë nga e paditura për ta vërtetuar dhe konstatuar në tersi gjendjen faktike dhe nga e cila kishte me rrjedh pastaj edhe aplikimi i saktë i të drejtës materiale. Gjykata ka trajtuar edhe Ligjin Nr.05/L-037, dhe atë në neni 22, par 3.2, ku jep definicionin se kur lind detyrimi tatimor, e ku specifikisht thuhet se : *“Kur fatura lëshohet para se mallrat dhe shërbimet të jenë furnizuar, TVSH-ja do të bëhet e ngarkueshme në momentin kur është lëshuar fatura”* , ndërsa në rastin konkret gjykata nuk ka gjetur të është lëshuar ndonjë faturë.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar në pjesën refuzuese, prandaj Gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohe lidhur me çështjet si më lartë dhe ta trajtoj dhe vlerësoj edhe njëherë mospranimin të humbjeve të ujit dhe mos pranimin e zhvlerësimit të Aseteve Rrjetit – Gypave, sipas Raportit të Kompanisë së licencuar G..., për periudhën kontestuese 2012-2013. Tutje e paditura në rivendosje të deklarohe edhe lidhur me pretendimin e ngritur nga pala paditëse në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor dhe atë lidhur me atë së ATK-ë me rastin e ushtrimit të Kontrollit për periudhën tatimore 2007-2011 në raport me këtu paditësin e pranon komplet zhvlerësimin përfshirë edhe rrjetin-gypat. Ndërsa ATK-ë, pasi kryen Kontrollin për vitin 2012-2013 nuk e pranon komplet zhvlerësimin, dhe atë zhvlerësimi që i referohet rrjetit-gypave, ngase kjo mund të paraqitet si aplikim i Standardeve të Dyfishta në raport me çështjen kontestuese, Zhvlerësim i Aseteve për këtu paditësin. Tutje të deklarohe edhe lidhur me Vendimin Shpjegues nr. 05/2009, dhe bazën ligjore në fuqi në raport me rivlerësimin e bërë nga një kompani e licencuar për Rivlerësim të Pasurisë-Aseteve, G..., për këtu paditësin, dhe vetëm pas kësaj dhe mbi

bazën e të gjeturave edhe nga provat e administruara, të sjell vendim të drejtë dhe të bazuar në legjislacionin tatimor të aplikueshëm.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*. Neni 7 Parag 1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.”* Nga këto dispozitat Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon pjesërisht dhe atë në pjesën refuzuese vendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedure të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, edhe duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.15/2022, datë 20.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.